


# CIKLI I VEPRIMTARIJE TË YOUNG IN PRISON NË HOLANDË

Çdo vit, përafërsisht 1200 të rinj dënohen dhe dërgohen në një institucion penitenciar për të rinjtë.



YOUNG IN PRISON  
NEDERLAND

## 13 aftësi për jetën të KOPOSHO

- Vetë-vlerësimi, bindja tek vetja, vetë-zhvillimi
- Empatia
- Komunikimi efektiv
- Menaxhimi i marrëdhënieve sociale
- Bashkëpunimi pozitiv
- Stimulimi i të menduarit krijues dhe kritik
- Përballja me emocionet
- Reflektime për veten
- Menaxhimi i stresit dhe pezmatimit
- Përballimi i konflikteve
- Veprime dhe vendimmarrje të pavarura
- Vënia e qëllimeve dhe planifikim me efektivitet
- Të qenurit një faktor pozitiv në shoqëri (vetëm pas lirimit)

## ÇFARË ËSHTË KOPOSHO-JA?

KOPOSHO-ja nënkupton KONtributin POzitiv në SHOqëri. Ky emër u zgjodh për metodën e Young in Prison, sepse qëllimi i të gjitha programeve që YiP vë në zbatim, është t'u mundësojë të rinjve të kontribuojnë pozitivisht në shoqëri pas lirimit të tyre nga sistemi i burgjeve. KOPOSHO është rezultat i përpjekjeve të bashkë-krijimit pas analizës së praktikave më të mira të programeve të YiP në të gjithë Evropën, Afrikën dhe Amerikën e Jugut.

Metodologjia KOPOSHO-s përdor artet dhe sportet si pikat hyrëse dhe përmes mbështetjes së gjerë përpara dhe pas lirimit, përpiket të rrisë aftësinë ripërtëritëse dhe vetëbesimin e të dënuarve të rinj dhe i mbështet ata në fitimin e aftësive jetësore bazë që do t'u mundësojnë atyre të kërkojnë punësim, e në fund duke lehtësuar ri-hyrjen e tyre në shoqëri. Kjo u mundëson atyre jo vetëm të ëndërrojnë për të ardhmen e tyre, por edhe të realizojnë këto ëndrra dhe të kontribuojnë pozitivisht në shoqëri.

KOPOSHO përdor 13 Aftësi Jetësore që (shpjeguar hollësisht në këtë dokument) mund të përdoren nga trajnuesit, në varësi të nevojave të të rinjve që kanë nën kujdes. Aftësitë më të zakonshme për jetën përfshijnë empati, përballimin e agresivitetit, rritjen e vetëbesimit dhe trajtimin e emocioneve. Pavarësisht formës së arteve që përdoret në veprimtarinë KOPOSHO, YiP gjithmonë përpiket të punojë drejt një produkti përfundimtar (të prekshëm). Në vitet e fundit, YiP e Holandës ka prodhuar disa albume muzikore, një dramë, një përmbledhje poezish dhe një numër ekspozitash të arteve vizive.

# RRETH ROLIT TË KOPOSHO-SË PËRMBRENDIA YIP

## Në Holandë, në një ditë të zakonshme...

... rreth 500 të rinj burgosen në qendrat e paraburgimit holandez. Shumë gjëra mund të kenë shkuar mbrapsht në jetën e tyre, mund të kenë marrë vendime të gabuara që i çuan aty ku janë, por Young in Prison beson se të gjithë meritojnë një shans të dytë - dhe nganjëherë edhe më shumë se një të dytë.

Për më shumë se gjysmën e të rinjve të burgosur, Young in Prison konsiderohet një moment pozitiv i të mësuarit; një moment frymëzimi, një shans i ri ose një shenjë e parë e ndryshimeve pozitive në të ardhmen. Si pjesë e metodologjisë së YiP - KOPOSHO - të për zhvillimin e tyre personal përmes punëtorive artistike dhe sportive. Përveç hapjes së një rruge për një të ardhme më të mirë, KOPOSHO shpesh çon në një mirëkuptim më të mirë ndërmjet të rinjve të dënuar dhe punonjësve të burgjeve, duke përmirësuar kushtet e jetesës brenda institucioneve të të rinjve.

Programi YiP kontribuon në riintegrimin e (ish) të dënuarve të tjerë të rinj, në uljen e shkallës së recidivizmit dhe në përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në sistemin e drejtësisë për të mitur, që është vetëm një nga shumë mënyrat e tjera në të cilat YiP kontribuon për një shoqëri më të sigurt.

YiP u themelua në Afrikën e Jugut në 2002 dhe Rrjeti Ndërkombëtar i YiP pasoi me programe në vende të tilla si Kolumbia, Kenia, Afganistani, Maroku dhe Holanda.

### Misioni dhe ndikimi

Young in Prison Holandë, kontribuon në riintegrimin pozitiv të të rinjve pas ndalimit, dhe në uljen e recidivizmit. Në këtë mënyrë, YiP kontribuon për një shoqëri më të sigurt.

### Qëllimi

Young in Prison përpiket të rehabilitojë ish të dënuarit e rinj përmes mos rikthimit në jetën kriminale me anë të: një motivimi afatgjatë dhe të brendshëm për të kundërshtuar sjelljen kriminale.

### Kjo arrihet duke

Inkurajuar, frymëzuar apo nxitur motivimin e brendshëm. Për këtë qëllim të rinjve duhet t'u plotësohen tre nevoja themelore – *teoria e vetëvendosjes*

### KOMPETENCAT

- Punëtorisë të bazuar në KOPOSHO në të cilën të rinjtë mësojnë aftësi të rëndësishme të jetës.
- Temat e punëtorive shpesh trajtojnë pyetje të rëndësishme të jetës - nxisin zhvillimin personal.

### AUTONOMIA

- Punëtorikreative dhe sportive që stimulojnë aktivizimin.
- Punë me objektiv produkte dhe prezantime artistike
- Të rinjtë marrin pjesë në hartimin e ciklit KOPOSHO.
- Në Youthlab, të rinjtë mësojnë të punojnë si konsulentë në sektorin e drejtësisë për të mitur. Përvojat dhe njohuritë e tyre janë të vlefshme.

### LIDHJET

- Trajnues frymëzues të punëtorive YiP të cilët punojnë mbi bazën e një marrëdhënieje horizontale dhe të barabartë.
- Mentorët e YiP që janë të gjindshëm ndaj të rinjve dhe nuk i përkasin suazës apo sistemit zyrtar.
- Një shok YiP i cili, në varësi të të kaluarës së tij / saj, mund të jetë dikush që të kupton dhe që të jep një perspektivë.

KUSH MUND  
TË TRAJNOHET  
NË KOPOSHO?

PËR ÇFARË  
SHËRBEJNË DOBITË  
E TRAJNIMIT  
KOPOSHO:

#### 1. PUNONJËSIT DHE DREJTUESIT E BURGUT:

- Punonjës do të jetë në gjendje të zhvillojnë mjete shtesë për të ofruar aktivitete kuptimplota që synojnë riintegrimin e të burgosurve. Këto mund të jenë veprimtari ose të reja ose të rishikuara nga veprimtaritë ekzistuese
- Njohuria dhe ndërgjegjësimi rreth metodologjisë KOPOSHO mund të çojë në ndërveprim të përmirësuar midis punonjësve të IEVP-së dhe të rinjve
- Stafi i trajnuar nga KOPOSHO-ja, do të jetë në gjendje të krijojë një mjedis të sigurt që stimulon zhvillimin e të rinjve të burgosur
- KOPOSHO-ja mund të ndihmojë përkrahjen e IEVP-ve në arritjen e qëllimeve të politikave të tyre (shkallë më të ulëta incidentesh, përmirësim të arsimit, përmirësim të trajtimit të të ndaluarve)

#### 2. ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE:

- Zbatimi i metodologjisë KOPOSHO do t'i aftësojë OShC-të që të bashkëveprojnë me të rinjtë në një mënyrë pozitive
- OShC-të zhvillojnë kapacitete për të krijuar veprimtari kuptimplota që synojnë zhvillimin personal dhe riintegrimin pozitiv të të rinjve
- KOPOSHO mund të përbëjë bazën për një partneritet të gjerë mes OShC-ve dhe institucioneve penitenciare të të rinjve nëse OShC-ja lejohet të drejtojë një program brenda burgut të të rinjve, në të cilin zhvillimi i aftësive personale është i lidhur me qëllimet arsimore të burgjeve dhe programin mësimor
- Të rinjtë fitojnë besim më lehtë kur punojnë

#### 3. LEHTËSUES TË PAVARUR PUNËTORISH:

- Trajnimi i lehtësuesve të pavarur të punëtorive për të zbatuar aktivitetet e KOPOSHO-s lehtëson ngarkesën e punës së punonjësve të burgjeve
- Të rinjtë mund të ndihen më pak të rezervuar për ndarjen e ideve ose përvojave të tyre kur kanë të bëjnë me dikë jashtë sistemit të burgjeve

Kandidatët që mund të trajnohen në KOPOSHO kanë një arsimim ose interes të fortë dhe talent në, pedagogji ose punë sociale dhe kanë përvojë pune në dramaturgji ose art si një mjet për të fuqizuar të rinjtë. Në rastin ideal, trajnuesit e KOPOSHO-s do të bëhen shembull, duke e bërë transferimin efektiv të njohurive shumë më të lehtë dhe më efektiv.

Pas ndjekjes së trajnimit KOPOSHO, çdo pjesëmarrës do të jetë në gjendje të zhvillojë, të japë ose të fillojë veprimtari kuptimplota (duke përdorur art, sport, dhe dramaturgji) përmes të cilave të rinjtë në konflikt me ligjin mund të zhvillojnë aftësi jetësore dhe të përjetojnë rritje personale.

### ÇFARË DOMETHËNIE MUND TË KETË KOPOSHO-JA PËR:

#### Të rinjtë

Grupi kryesor i synuar i metodologjisë KOPOSHO janë të rinjtë që janë brenda një qendre të paraburgimit për të mitur si pasojë e dënimit për një vepër penale. Përmes pjesëmarrjes në një punëtori KOPOSHO:

- Të rinjtë ndjehen të frymëzuar dhe të motivuar për të ndryshuar jetën e tyre për mirë
- Ata përjetojnë rritje të ndjeshme personale
- Aftësia ripërtëritëse dhe vetëbesim janë rritur ndjeshëm.

#### Youth prisons

Incorporating COPOSO will enable prison management and staff to develop and implement meaningful activities that are focused on the positive re-integration of youth into society. Implementing COPOSO results in:

- Youths engaging in meaningful activities
- Empowered CSOs (Civil Society Organizations) that are able to support prisons
- Improved group environment within the detention centers
- Decrease of violence & aggression during workshops

#### Fakte rreth YiP në Holandë

- 1200 të rinj dënohen në Holandë çdo vit
- YiP punon në 5 nga 7 qendrat e paraburgimit holandez
- Nivele më të ulëta të incidenteve të raportuara brenda qendrave gjatë dhe pas programeve të YiP
- 80% e pjesëmarrësve përjetojnë zhvillim pozitiv personal pas punëtorive KOPOSHO
- Rënie të ndjeshme të recidivizmit midis pjesëmarrësve në të gjithë programin global YIP

### SI MUND TË LIDHET KOPOSHO-JA ME OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË IEUP-SË?

- Veprimtaritë e KOPOSHO-së, mund të përfshihen në programin mësimor të të rinjve
- Veprimtaritë e KOPOSHO-së mund të përfshihen në programin ditor të të rinjve të burgosur (veprimtari të kohës së lirë)
- Veprimtaritë e KOPOSHOs mund të lidhen me metodologjitë e tjera, si You-turn / Tops-framework
- KOPOSHO-ja mund të çojë në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në hartimin e politikave, duke rezultuar në përmirësimin e atmosferës dhe metodave të kujdesit

“PRANIA E YIP DHE METODOLOGJIA E KOPOSHO-SË KONTRIBUOJNË NË NJË ATMOSFERË TË PËRMIRËSUAR PEDAGOGJIKE NË INSTITUCIONIN TONË. TRAJNUESIT E YIP-SË JANË ME TË VËRTETË TË PËRKUSHTUAR DHE JO ME FRYMË KRITIKE, GJË QË KRIJON NJË MJEDIS TË SIGURT MËSIMOR DHE NXIT TË RINJTË TË MARRIN PJSË DHE TË PUNOJNË DREJT ARRITJES SË QËLLIMEVE TË TYRE PERSONALE TË ZHVILLIMIT”

Joris van den Boer, drejtori i qendrës së paraburgimit Kompascollege në de Hartelborgt.

“KY PROGRAM KA PËRMIRËSUAR VETËU-LEHËSIMIN TIM. FILLIMISHT NDJEHESHA I PADOBISHËM, QË NUK BËJA PËR ASGJË, PA POTENCIAL. POR, PAS PJESËMARRJES NË PROGRAMIN KOPOSHO, KAM KUPTUAR SE JAM DIKUSHI, SE KAM POTENCIAL SI ÇDO I RI TJETËR DHE SE MUND T’I REALIZOJ ËNDRRAT E MIA. VETËBESIMI IM ËSHTË SHTUAR TASHMË.”

Pjesëmarrës në programin YiP.